



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 473/1 prot.

Tiranë, më 29.05.2018

VENDIM

Nr. 53, datë 29.05.2018

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 187, DATË 05.09.2017**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 187, datë 05.09.2017, “Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar me urdhrin e verifikimit nr. 133/2 prot., datë 03.03.2017”,

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet informacionit me nr. 133 prot., datë 20.02.2017, nëpunësja ***** , ka parashtruar përpara Komisionerit disa pretendime për parregullsi lidhur me ligjshmërinë e procedurës së transferimit të saj, për shkak të ristrukturimit të këtij institucioni.

Për të sqaruar rrethanat e rastit, Komisioneri, me Urdhrin nr. 133/2 prot., datë 03.03.2017, ka nisur fillimin e verifikimit të këtij informacioni. Në përfundim të hetimit administrativ procesi është përmbyllur me Vendimin Nr. 187, datë 05.09.2017, “Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar me urdhrin e verifikimit nr. 133/2 prot., datë 03.03.2017”, në të cilin është vendosur:

“1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, që për punonjësen ***** , të vijojë me plotësimin e aktit, në zbatim të përfitimeve që rrjedhin prej nenit 50, pikave 7 dhe 8, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, që kanë të bëjnë me dhënien e

një dëmshtëpërblimi, në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil dhe mundësinë që brenda një periudhe 2 vjeçare, të konkurrojë si nëpunëse civile për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, ose të emërohet në mënyrë të përkohshme, me pëlqimin e saj, në pozicione të shërbimit civil, që lirohen përkohësisht, për shkak sëmundje, leje lindje e arsye të tjera ligjore.

*2. Njësia përgjegjëse, duhet të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë, në përlllogaritjen e dëmshtëpërblimit, që punonjësja ***** përfiton si pasojë e lirimit nga shërbimi civil, për shkak të ristrukturimit të institucionit dhe ndryshimit të kriterëve të vendit të punës, duke pasur parasysh si pozicion të mëparshëm të punës, atë të “Drejtor në Drejtorinë e Hartimit dhe Monitorimit të Projekteve”, kategoria e pagës II-b, ku edhe punonjësja është deklaruar si nëpunëse civile.*

3. Dëmshtëpërblimi duhet të fillojë të paguhet, duke nisur nga data e daljes së aktit administrativ që e liron punonjësën nga shërbimi civil, në zbatim të përfitimeve që rrjedhin prej nenit 50, pikës 7, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

4. Për të gjithë kohën tjetër, para daljes së aktit të lirimit nga shërbimi civil, kur punonjësja nuk është paguar, duhet të marrë pagën e Sekretarit të Përgjithshëm, detyrë të cilën e ka kryer deri në momentin e daljes së aktit të lirimit nga shërbimi civil.

5. Në të ardhmen, njësia përgjegjëse duhet të bëjë kujdes dhe të zbatojë me përpikmëri procesin e ristrukturimit të institucionit, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke filluar me ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, i cili duhet të funksionojë dhe veprojë sipas përcaktimeve dhe afateve të përcaktuara në kreun II të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë”.

6. Këshilli i Qarkut Shkodër, të zbatojë vendimin brenda 15 ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas përfundimit të këtij afati, të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për zbatimin e vendimit.”

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve në Vendimit Nr. 187, datë 05.09.2017, “Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar me urdhrin e verifikimit nr. 133/2 prot., datë 03.03.2017”, Komisioneri me shkresën nr. 1652/1 prot., datë 04.10.2017 dhe shkresën nr. 368 prot., datë 29.03.2018, ka kërkuar nga institucioni i verifikuar të njoftojë në lidhje me zbatimin e vendimit paralajmërues duke bashkëngjitur edhe praktikën shkresore që materializon zbatimin e tij. Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, Këshilli i Qarkut Shkodër, me shkresat nr. 943 prot., datë 09.10.2017, “Informacion në lidhje me zbatimin e vendimit Nr. 187, datë 05.09.2017, “Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar me urdhrin e verifikimit nr. 133/2 prot., datë 03.03.2017”” dhe nr. 349 prot., datë 20.04.2018, “Përgjigje shkresë”, ka

dërguar dokumentacionin që materializon zbatimin e rekomandimeve të vendimit objekt verifikimi.

Në analizë të të gjithë praktikës shkresore të këtij rasti, vërej se:

Në pikën 1 të vendimit paralajmërues, njësisë përgjegjëse i është lënë detyrë të plotësojë aktin e lirimit, në zbatim të përfitimeve që rrjedhin prej pikave 7 dhe 8 të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar (që kanë të bëjnë me dhënien e një dëmshpërblimi, në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil dhe mundësinë që brenda një periudhe 2-vjeçare, të konkurrojnë si nëpunëse civile për procedurat e parashikuara nga ligji).

Rekomandimi i mësipërm, formalisht, nuk është zbatuar nga njësia përgjegjëse (sikundër do të analizohet në vijim, punonjësja ka përfituar *de facto* të drejtat e njohura nga dispozitat e sipërcituara).

Akti i lirimit për të cilin është nxjerrë ky rekomandim është një akt administrativ individual, i cili shuan një marrëdhënie juridike konkrete. Në rast të plotësimit të tij në përputhje me rekomandimin e Komisionerit, ky akt do të kishte edhe karakter dobiprurës. Referuar Komentarit të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, akti administrativ është dobiprurës nëse përcakton ose konfirmon një të drejtë ose një avantazh ligjor përkatës. Në rastin konkret, e drejta për dëmshpërblim në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil dhe e drejta për të konkurruar si nëpunëse civile brenda një periudhe 2-vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, si pasojë e ristrukturimit, janë të sanksionuara në nenin 50 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar. Fakti nëse këto të drejta janë përmendur ose jo në aktin e lirimit, nuk e cenon në thelb gëzimin e tyre nga titullari i së drejtës, në rastin konkret nga punonjësja *****. Përfitimi i një të drejte me ligj, passjell detyrimin e organit apo organeve kompetente administrative që, në përputhje me kriteret që vendos ligji, t'i njohin këtë të drejtë titullarit të saj.

Nga listëpagesat dhe urdhër-shpenzimet bashkëlidhur shkresës nr. 349 prot., datë 20.04.2018, *“Përgjigje shkrese”*, të Këshillit të Qarkut Shkodër, konstatoj se punonjësja ka përfituar dëmshpërblimin si pasojë e lirimit nga shërbimi civil, për shkak të ristrukturimit, në përputhje me rekomandimet e lëna në pikat 2 dhe 3 të vendimit objekt verifikimi.

Nga aktet e mësipërme, vërej se punonjësja ka përfituar gjithashtu pagën e Sekretarit të Përgjithshëm (detyrë të cilën e ka kryer deri në momentin e daljes së aktit të lirimit), për periudhën që nuk është paguar, sikundër është kërkuar në pikën 4 të vendimit paralajmërues.

Për sa u parashtrua më sipër, arrij në përfundimin se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Këshillit të Qarkut Shkodër janë zbatuar rekomandimet e

lëna në Vendimin Nr. 187, datë 05.09.2017, “Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar me urdhrin e verifikimit nr. 133/2 prot., datë 03.03.2017”, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 187, datë 05.09.2017, “Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar me urdhrin e verifikimit nr. 133/2 prot., datë 03.03.2017”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e subjektit të inspektuar Këshilli i Qarkut Shkodër, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 187, datë 05.09.2017.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Këshilli i Qarkut Shkodër dhe ankuesja
*****.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha